



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 07 nëntor 2019, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. T'i propozojë Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) të mos faturojë për muajin shtator, subjektet analogë vendorë që ofrojnë shërbim në qarqet Tiranë, Durrës për mbështetjen e programeve të tyre në rrjetin e RTSH-së. **(Vendimi nr. 158, datë 07.11.2019)**
2. Rinovimin e licencës së shoqërisë "Radio Alson" sh.p.k., për subjektin audio privat "Radio Club Alson" dhe azhurnimin e zonës së ofrimit të shërbimit nga "Qyteti Elbasan" në "Bashkitë Elbasan, Cërrik dhe Belsh". **(Vendimi nr. 159, datë 07.11.2019)**
3. Heqjen e licencës të subjektit person fizik Ismail Buçpapa, për subjektin audioviziv privat "Tv Bajram Curri". **(Vendimi nr. 160, datë 07.11.2019)**
4. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës për transmetime analoge të shoqërisë "Margit Tv" sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor "Tv Margit". **(Vendimi nr. 161, datë 07.11.2019)**
5. Rrëzimin e aplikimit të subjektit person fizik Gerantina Zylo, për marrje autorizimi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "FastNet". **(Vendimi nr. 162, datë 07.11.2019)**
6. Mosrinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Edi Tanushi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "TV kabllor Danja". **(Vendimi nr. 163, datë 07.11.2019)**
7. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë "Procom" sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Procom" në "Bashkinë Belsh". **(Vendimi nr. 164, datë 07.11.2019)**
8. Pranimin e kërkesës së shoqërive "Premium Media" sh.p.k. dhe "Radio Travel" sh.p.k. për kalimin e të drejtave të licencës së shoqërisë "Radio Travel" sh.p.k., për subjektin audio privat "Radio Travel" tek shoqëria "Premium Media" sh.p.k. **(Vendimi nr. 165, datë 07.11.2019)**
9. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë të shoqërisë "DIGICom" sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV) "DIGICom". **(Vendimi nr. 166, datë 07.11.2019)**

10. Kalimin e të drejtave të autorizimit të subjektit person fizik Gëzim Caka, për përsëritjen e shërbimit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Zargoçan”, tek subjekti person fizik Dorjan Pere. **(Vendimi nr. 167, datë 07.11.2019)**
11. Refuzimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Albi Kreçi dhe lënien në fuqi të vendimit me gjobë nr.17, datë 16.09.2019, në masën 1,000,000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit për subjektin “Tv me kabëll Alb Vito Peqin”. **(Vendimi nr. 168, datë 07.11.2019)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE